

Përshendetje,

Në vazhdim të komunikimit lidhur me zbatimin e udhëzuesit nr. 15 (52 prot.) datë 15.01.2025 të Komisionerit “Për unifikimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore; pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor; respektimit të të drejtave të tyre politike e detyrimeve ligjore; nfdërveprimin e nëpunësve civilë me platformat apo rrjetet sociale që shfaqen për publikun nëpërmjet internetit, për të shmangur propagandën elektorale; si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën” si dhe urdhërit të brendshëm nr. 9 (46 prot.), dt. 14.01.2025, të Komisionerit “Për krijimin e grupit të gatshëm dhe organizimin e procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil me objekt veprimtarie emerimet e reja dhe sjellja e nëpunësve civil gjatë procesit zgjedhor”, nisur nga disa kërkesa të administruara nga Grupet e Monitoritmi, lidhur me metodologjinë e mbikëqyrjen e veprimtarisë së nëpunësve civile, në përbërje të organeve zgjedhore (KZAZ), ju sqarojmë:

Së pari: Neni 19, i vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, i KQZ, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor” e rregullon në mënyrë specifike, kohën e punës për KZAZ-të, ashtu si paraqitet në linkun:

https://cec.org.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendim-005_organizmi_funksionimi_KZAZ.pdf

Së dyti: Të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, duhet të rakordojnë me institucionin e KQZ-së, listën e tyre të punonjësve që marrin pjesë në organet zgjedhore, si dhe të kërkojnë sqarime nga ky institucion për çdo aspekt që ka lidhje me fushën e tij të veprimit.

Ndërkohë, në lidhje me raportimin ditor të prezencës në punë të punonjësve, si dhe me aplikimin e institutive të ligjit të shërbimit civil gjatë periudhës zgjedhore, për lehtësi të llogaritjes dhe mbajtjes së statistikave, po ju dërgojmë disa tabela në excel, që do të plotësohen nga ana juaj, me qëllim unifikimin e raportimit.

- **Tabela nr. 1:** Monitorimi ditor i institucionit
- **Tabela nr. 2:** Të dhëna për aplikimin e instituteve të ligjit për shërbimin civil për periudhën 11.04.2025-11.05.2025
- **Tabela nr. 3:** Rastet e pjesëmarrjes në organet zgjedhore

Për çdo informacion të përditësuar do e gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit: www.kmshe.al

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri